



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 724 Akti

Nr. 756 Vendimi
Tiranë, më 9.4.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 5.4.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Klerona Meçi**, ndihmëse ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoi subjektin në seancë dëgjimore, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Klerona Meçi është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për shkak të funksionit të saj si , ndihmëse ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme.
2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Klerona Meçi i është nënshtuar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Pamela Qirko dhe Xhensila Pine (relatore).
3. Komisioni ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesuese komisioneren Alma Faskaj dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.
5. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, datë 7.12.2003, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Klerona Meçi, për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe nenet 45-47 e 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave e thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.
6. Në datën 7.12.2023, subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për sjelljen e provave dhe shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës deri në datën 18.12.2023. Me kërkesën e datës 14.12.2023 subjekti kërkoi kohë shtesë për të sjellë prova dhe shpjegime. Me vendimin nr. 3, datë 15.12.2023, Komisioni vendosi të pranojë kërkesën e subjektit, duke e shtyrë afatin deri në datën 5.1.2024.
7. Trupi gjykues, pas marrjes së provave dhe shpjegimeve nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. 4, datë 11.1.2024, ka vendosur të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në datën 15.1.2024, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, Tiranë. Pas seancës dëgjimore, trupi gjykues u tërhoq për vendim.
8. Me vendimin nr. 5, datë 15.1.2024, trupi gjykues vendosi të rihapë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit, me qëllim që të rihetohet në lidhje me kontratat e kaparit, të cilat janë paraqitur së bashku me parashtrimet e subjektit, duke hetuar pasqyrimin në llogaritë bankare dhe organet tatimore të të ardhurave të gjeneruara prej tyre.
9. Me vendimin nr. 6, datë 20.3.2024, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimin administrativ shtesë dhe të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ shtesë të kryer mbas riçeljes së hetimit.
10. Me vendimin nr. 7, datë 2.4.2024, trupi gjykues vendosi të thërrasë në seancë dëgjimore subjektin e rivlerësimit, në datën 5.4.2024, ora 10:00.
11. Në datën 5.4.2024 u zhvillua seanca e dytë dëgjimore në prani të subjektit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.
12. Në datën 9.4.2024, ora 09:45, u shpall vendimi përfundimtar.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë të subjektit të rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Komisioni kreu një hetim të pavarur, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimet nr. 2 dhe nr. 17, viti 2017, të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaramit të bërë nga ky subjekt, e të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkrese të administruara në dosje.

15. Nga analiza e të dhënave të vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike/vjetore dhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuara në ILDKPKI, verifikimi i materialeve shkrese të administruara dhe të dhënave të përfituara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni për pasuritë e subjektit dhe të personave të lidhur me të kanë rezultuar si vijon:

16. Apartament banimi me sip. 102.6 m², në *, Tiranë**

16.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* këtë apartament në përdorim të saj, të blerë nga babai, shtetasi I.M, në shumën 79,500 euro dhe në pronësi të tij, duke bashkëlidhur edhe kontratën e sipërmarrjes së datës 19.7.2016.

16.2 Në bazë të kontratës së sipërmarrjes të datës 19.7.2016, shtetasi I.M ka porositur tek shoqëria “****” sh.p.k. një ambient banimi me sip. 102,6 m², në kullën nr. ***, shk. ***, me kat teknik nr. ***, ap. banimi nr. ***, në komunën ***, Tiranë, kundrejt çmimit 79,500 euro.

16.3 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me shkresat nr. *** prot., datë 5.2.2021, *** prot., datë 5.2.2021, si dhe nr. *** prot., datë 2.2.2021, informon Komisionin se nuk ka pasuri të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të. Gjithashtu, sipas informacionit të dosjes së ILDKPKI-së, ZQRPP me shkresën nr. *** prot., datë 15.8.2017, nuk konfirmon të regjistruar pasuri në emër të subjektit.

16.4 FSHU-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2021, ka bërë me dije për Komisionin se në emër të subjektit të rivlerësimit nuk kanë rezultuar kontrata të lidhura për shërbime të energjisë elektrike. Ndërsa në emër të z. I.M, referuar të dhënave, evidentohen 2 abonentë me kontrata furnizimi nr. *** në instancën Tiranë, që rezultojnë të hapura në datën 12.10.2017, kategoria - familjare, me adresë “****”, *** dhe nr. *** në instancën Gjirokastër.

16.5 UKT-ja, me shkresën *** prot., datë 28.1.2021, konfirmon për Komisionin se në emër të subjektit dhe personave të lidhur nuk rezulton asnjë kontratë për shërbime ujësjellësi të regjistruar në emër të tyre.

16.6 Në pyetësoin standard¹, subjekti ka deklaruar se: “...Nga data 1.1.2017 dhe aktualisht banoj në adresën rruga “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, ***, ***, ***, Tiranë. Apartamenti është në pronësi 100% të babait, blerë me kontratën e sipërmarrjes nr. *** kol., nr. *** rep., datë 18.7.2016”.

Në lidhje me çmimin e blerjes dhe kohën e pagesës

16.7 Në kontratën e sipërmarrjes sa më sipër cituar, është përcaktuar se sipërmarrësi merr përsipër dorëzimin me çelësa në dorë të sipërfaqes ndërtimore brenda shtatorit 2016, ndërsa për sa i përket çmimit të blerjes 79,500 euro është dakordësuar që kësti i parë 40,000 euro të likuidohet me firmosjen e kontratës nëpërmjet Raiffeisen Bank, në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., dhe kësti i dytë 39,500 euro të likuidohet me kliring (pllaka dhe hidrosanitare), specifikat do të shoqërohen me një aktmarrëveshje të veçantë midis palëve.

16.7.1 Subjekti në deklaratën *Vetting* dhe në pyetësoin standard nuk ka deklaruar nëse nga babai i saj ishte shlyer çmimi i plotë për blerjen e këtij apartamenti.

16.7.2 Noterja M.D² konfirmon përfitimin e apartamentit sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.7.2016, duke vendosur bashkëlidhur kontratën e sipërmarrjes, dokumentacionin e objektit, si dhe gjashtë fatura tatimore, më konkretisht: (i) fatura nr. ***, datë 1.6.2017, me vlerë totale 5,459,200 lekë, me përshkrimin “Parapagim për shitje sipas kontratës datë 19.7.2016, me blerës I.M.”; (ii) fatura nr. ***, datë 7.5.2018, me vlerë totale 3,600 euro, me përshkrimin “Parapagim për shitje sipas kontratës datë 13.7.2016, blerës I. M.”; (iii) fatura nr. ***, datë 10.10.2018, me vlerë totale 4,787.75 euro, me përshkrimin “Parapagim për shitje sipas kontratës datë 18.7.2016, ***”; (iv) fatura me nr. ***, datë 15.11.2018, me vlerë totale 7,353 euro, me përshkrimin “Parapagim për shitje sipas kontratës datë 18.7.2016, ***”; (v) fatura nr. ***, datë 23.11.2018, në shumën 11,905 euro, me përshkrimin “Parapagim për shitje sipas kontratës datë 18.7.2016”; (vi) fatura nr. ***, datë 24.12.2018, me vlerë totale 10,569 euro (1,300,000 lekë), me përshkrimin “Parapagim për shitje sipas kontratës datë 18.7.2016”.

16.7.3 Referuar të dhënave nga Raiffeisen Bank, rezulton se në datën 19.7.2016, nga llogaria nr. *** në USD, në emër të babait të subjektit, shtetasit I.M, është transferuar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. shuma 44,360 USD, me përshkrimin “Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 18.7.2016, pagesë kësht blerje apartamenti”.

16.7.4 Shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., me shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 12.5.2023, ka informuar Komisionin se vlera e kontratës është 79,500 euro, dhe klienti I.M ka likuiduar vlerën 78,215 euro, se diferenca prej 1,285 euro do të likuidohet nga ana e klientit kur apartamenti të pajiset me certifikate pronësie, gjithashtu ka informuar se pagesat janë kryer:

- në datën 19.7.2016, në vlerën 40,000 euro, në Raiffeisen Bank;
- në datën 7.5.2018, në vlerën 3,600 euro, në BKT;
- në datën 10.10.2018, në vlerën 4,788 euro, në BKT;
- në datën 15.11.2018, në vlerën 7,353 euro, në BKT;
- në datën 23.11.2018, në vlerën 11,905 euro, në Raiffeisen Bank;

¹ Datë 22.1.2021.

² Shkresë kthim përgjigjeje, administruar në Komision me nr. *** prot., datë 15.5.2023.

- në datën 24.12.2018, në vlerën 10,569 euro, në Raiffeisen Bank.

16.7.5 Kjo shoqëri ka sqaruar se: “...*Marrëveshja me kliring, e cituar në këstin e dytë, prej 39,500 euro, në nenin 3 të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, redaktuar më 19.7.2016, nuk është nënshkruar asnjëherë nga palët, pasi ata u dakordësuan për shlyerjen me këste si më sipër...*”.

16.7.6 Komisioni konstatoi se fatura e shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. nr. ***, datë 1.6.2017, me vlerë totale 5,459,200 lekë, me përshkrimin “Parapagim për shitje sipas kontratës datë 19.7.2016”, me blerës I.M, duket se nuk përputhet në kohë me shumat e paguara nga shtetasi I.M, për më tepër që në të dhënat e disponuara nga Komisioni shoqëria “****” sh.p.k., me ortak dhe administrator shtetasin I.M, ka faturuar për periudhën dhjetor 2016 shumën prej 1,891,346 lekësh dhe për periudhën janar 2017 – mars 2017 shumën prej 997,901 lekësh (vlerë përfshirë TVSH-në) për shoqërinë “****” sh.p.k.

16.7.7 Për sa më sipër, për të qartësuar çmimin real të blerjes së apartamentit, kohën dhe mënyrën e likuidimit të tij, iu kërkua shoqërisë ndërtuese të shpjegojë në lidhje me këto faturime, si dhe nëse janë lidhur kontrata të tjera porosie/shitje ose forma të tjera (përveç kontratës së sipërmarrjes të datës 19.7.2016) me shtetasin I.M si individ dhe/ose administrator të ndonjë shoqërie tregtare.

16.7.8 Shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., me shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2023, ka shpjeguar se fatura tatimore nr. ***, datë 1.6.2017, është arkëtuar në llogarinë e shoqërisë në datën 19.7.2016, ndërsa për sa i përket faturave tatimore të lëshuara nga shoqëria “****” sh.p.k., për periudhat dhjetor 2016 dhe janar – mars 2017, është sqaruar se këto faturime nuk kanë qenë pjesë të kontratës së sipërmarrjes së datës 19.7.2016 ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit I.M. Gjithashtu, kjo shoqëri informon se nuk ka pasur kontrata të tjera porosie/shitjeje ose forma të tjera me shtetasin I.M si individ dhe/ose administrator të ndonjë shoqërie tregtare, përveç shoqërisë “****” sh.p.k.

16.7.9 Sa më sipër, transaksionet e kryera ndërmjet shtetasit I.M, shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. dhe shoqërisë “****” sh.p.k. (e cila ka për ortak dhe administrator shtetasin I.M) kanë sjellë një paqartësi si në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit në përdorim nga subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe me mënyrën e likuidimit të tij.

16.7.10 Sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kërkoi shpjegime dhe prova subjektit për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit.

Analizë e burimit të të ardhurave dhe mundësia financiare

16.8 Në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar burim të të ardhurave të babait të saj për pagesën e çmimit të blerjes dhe si pjesë e dosjes *Vetting* është bashkëlidhur vetëm kontrata e sipërmarrjes, ndonëse është pranuar përdorimi i kësaj pasurie prej saj në mënyrë të vazhdueshme.

16.8.1 Referuar udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm pranë ILDKPKI-së³, subjekti i rivlerësimit është i detyruar të deklarojë burimin e të ardhurave të

³ “Për mënyrën e deklarimit të pasurive në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

krijimit të pasurive në pronësi ose përdorim, si dhe të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për pronësinë dhe burimin e krijimit të pronës.

16.8.2 Sa më sipër, subjekti nuk ka përmbushur këtë kërkesë ligjore me deklaratën *Vetting*.

16.8.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se: “...babai im ka qenë i angazhuar në biznes që prej vitit 1993 e deri sot. Konkretisht:

- Në vitin 1993 është regjistruar si person fizik me objekt “Tregtimi i materialeve të ndërtimit, kryesisht beton”. Ky aktivitet është zhvilluar deri në vitin 1996. Nuk disponon dokumentacion për këtë fakt për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. Im atë më sqaron se, duke qenë se ky ishte një ndër bizneset e para në këtë fushë në Gjirokastrë, ka realizuar të ardhura dhe fitime të konsiderueshme.
- Në vitin 1995, me anë të vendimit nr. ***, datë 31.3.1995, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, është themeluar shoqëria “***” sh.p.k., në të cilën babai im I.M zotëronte 34% të kapitalit. Kjo shoqëri është regjistruar në Drejtorinë e Tatimeve Gjirokastrë më 1.7.1996, me NIPT-in *** dhe objekti i aktivitetit të saj ishte “tregti e përgjithshme, import-eksport, prodhim dhe tregtim i materialeve të ndërtimit, ndërtim (zbatim) i projekteve ndërtimore për objekte private, sociale etj”. Nga kjo shoqëri babai im është larguar në datën 17.3.2003 me anë të vendimit nr. ***, datë 17.3.2003, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, duke ia shitur kuotat 2 ortakëve të tjerë. Im atë më sqaron se kjo shoqëri ishte ndër të parat dhe më e madhja në Gjirokastrë në atë kohë dhe se aktiviteti ka qenë i konsiderueshëm.
- Në vitin 2003, me anë të vendimit nr. ***, datë 23.1.2003, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, u themelua shoqëria “***” sh.p.k. Kjo shoqëri është regjistruar në Drejtorinë e Tatimeve Gjirokastrë, në datën 6.3.2003, me NIPT-in *** dhe objekti i aktivitetit të saj është “Prodhimi dhe tregtimi i të gjitha materialeve të ndërtimit, si dhe tregti e përgjithshme me shumicë dhe pakicë import-eksport”. Kjo shoqëri vazhdon të ushtrojë aktivitetin e saj dhe aktualisht im atë zotëron 82.5 % të kuotave të kapitalit të saj.
- Në datën 18.11.2009 është regjistruar pranë QKB-së shoqëria “***” sh.p.k., me NIPT ***, në të cilën im atë zotëron 50% të kuotave të kapitalit. Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie është “Shitje banesash, investime në fushën e ndërtimit të objekteve të ndryshme, si dhe shitje e këtyre objekteve. Ndërtim objektesh industriale, social-kulturore dhe i banesave. Tregti e përgjithshme e të gjitha llojeve të mallrave, me shumicë dhe me pakicë”. Kjo shoqëri vazhdon të jetë aktive.
- Në datën 28.12.2009 është regjistruar pranë QKB-së shoqëria “***” sh.p.k., me NIPT ***, në të cilën im atë zotëronte 39 % të kuotave të kapitalit. Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie ishte “Shitje banesash”. Në lidhje me të ardhurat e krijuara nga kjo shoqëri, rezulton se z. I.M ka tërhequr dividend (pjesën që i takonte prej 39%) në shumën 1,950,000 lekë. Për këtë shumë është paguar tatimi i dividendit në shumën totale 866,700 lekë (vërtetuar me mandatet përkatëse). Kjo shoqëri aktualisht është “shoqëri në likuidim e sipër”.
- Në datën 16.10.2014 është regjistruar pranë QKB-së shoqëria “***” sh.p.k., me NIPT ***, në të cilën im atë zotëron 100% të kuotave të kapitalit. Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie është “Investime në fushën e ndërtimit dhe shitjes së apartamenteve të banimit. Tregti e përgjithshme import - eksport me shumicë dhe me pakicë, e mallrave të ndryshe industriale,

ushqimore, blegtorale, materiale ndërtimi, hidrosanitare, automjete, pjesë këmbimi për automjete etj. Ndërtim objektesh të ndryshme, industriale, tregtare, ujësjellësish, rrugësh etj”. Kjo shoqëri vazhdon të jetë aktive.

...gjatë gjithë këtyre viteve, babai im ka qenë i angazhuar në biznesin e lidhur me tregtimin e materialeve të ndërtimit, punimeve të ndërtimit etj. Përveç qenies së tij si ortak, në shumicën e shoqërive të sipërpërmendura ka pasur edhe rolin e administratorit. Në këtë kuadër, im atë më sqaron se në mënyrë të vazhdueshme si pjesë e punës së tij si administrator i këtyre shoqërive bën edhe menaxhimin e mjeteve monetare të këtyre shoqërive (llogarive bankare dhe arkave të shoqërive). Gjithashtu, im atë më sqaron se ka qenë në mënyrë të vazhdueshme i punësuar pranë këtyre shoqërive dhe se janë paguar rregullisht kontribute në emër të tij. Me kërkesën time më paraqiti një vërtetim për pagesën e kontributeve nga viti 2012 e në vazhdim, ndërkohë më informoi se ka bërë kërkesë tek ISSH-ja për vitet para 2012 dhe është në pritje të përgjigjes. Vetëm për periudhën 2012 – 2018 (periudhë e kryerjes së pagesave për të cilat kërkohet informacion) të ardhurat nga paga e babait tim kanë qenë rreth 8,000,000 lekë.

Rrjedhimisht, të ardhurat e konfirmuara vetëm nga paga e babait tim, pa përfshirë të ardhurat e familjarëve të tjerë dhe llogaritë e bizneseve që ka zhvilluar në vite, vlerësoj se janë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të kërkuara në këtë pyetje.

*Në momentin e pagesës së kështit të parë, im atë ka pasur gjendje në llogaritë e tij personale, konkretisht në llogarinë e tij personale pranë Raiffeisen Bank, me nr. ***. Nga kjo llogari im atë ka kryer lëvizje të ndryshme, përfshirë investime në depozita me afat, investime në fonde investimi që ofronte vetë banka etj. Të ardhurat e realizuara nga këto depozita dhe fonde investimi janë tatuar nga banka në formën e tatimit në burim.*

*Në lidhje me origjinën e këtyre parave, im atë është hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, ku në përfundim është vendosur pushimi i procedimit penal (vendim nr. ***, viti 2014). Në konkluzionet e këtij vendimi arrihet në përfundimin se origjina e parave të babait tim është nga aktiviteti i tij tregtar”.*

16.8.4 Subjekti deklaron se burimi për blerjen e këtij apartamenti, duke përfshirë të gjithë vlerën e tij, kanë qenë të ardhurat nga veprimtaria që lidhet me aktivitetin në fushat e biznesit të përshkruara më sipër dhe shitja e pasurive të paluajtshme të familjes, shfrytëzimi i pasurive të paluajtshme në emër të bizneseve, të ardhura të tjera që lidhen me pagat e babait dhe anëtarëve të tjerë të familjes.

16.8.5 Subjekti ka depozituar, ndër të tjera, edhe: (i) mandatpagesa për apartamentin; (ii) ekstrakte historike të QKB-së, të shoqërive tregtare “****” sh.p.k., “****” sh.p.k., “****” sh.p.k., “****” sh.p.k., “****” sh.p.k., “****” sh.p.k.; (iii) dokumentacion nga Raiffeisen Bank për tërheqje dividendi nga z. I.M në datën 24.12.2010 të shumës 1,950,000 lekë; (iv) pagesë tatimi për dividend datë 31.12.2010 në Raiffeisen Bank; (v) vërtetim kontributesh pas vitit 2012 për shtetasin I.M; (vi) printim pjesor i lëvizjeve në llogarinë në USD pranë Raiffeisen Bank në emër të shtetasit I.M.

16.8.6 Pas analizimit të përgjigjeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti sa më sipër, Komisioni vlerëson se burimi i të ardhurave të babait të subjektit për pagesën e çmimit të blerjes së kësaj pasurie në përdorim të subjektit nuk është deklaruar qartë me analizë si në kohë, ashtu

edhe në vlerë, por është pasqyruar i përgjithshëm dhe shumë i gjerë në periudhë kohore, në llojin e të ardhurave të pretenduara të përfituara dhe pa i dokumentuar plotësisht ato.

Në lidhje me pagesën e këstit të parë, në shumën 40,000 euro, në datën 19.7.2016

16.9 Komisioni, pas analizës së veprimeve/lëvizjeve bankare në llogarinë në USD, në emër të babait të subjektit në Raiffeisen Bank (nr. ***), nga e cila në datën 19.7.2016 u transferua për shoqërinë “****” sh.p.k. shuma prej 44,360 USD për pagesën e këstit të parë të blerjes së apartamentit, konstatoi se:

16.9.1 Kjo llogari bankare është hapur në datën 20.6.2013. Në datën 27.7.2013 është transferuar me këmbim shuma 166,980 USD dhe, nga kjo shumë, në datën 1.4.2014 është tërhequr *cash* shuma 10,000 USD, ndërsa në datën 11.4.2014 i është dhënë hua shtetases S.B. shuma 137,000 USD, e cila është kthyer në datën 15.4.2014, në shumën 137,500 USD.

16.9.2 Në datën 9.5.2014, nga kjo llogari është transferuar për ortakun tjetër shuma 100,000 USD dhe gjendja në llogari ka mbetur në vlerën 57,491 USD.

16.9.3 Për periudhën 9.5.2014 – 19.7.2016, kjo llogari (përveç interesave debitorë/kreditorë) është debituar në shumën 25,000 USD për një hua dhënë shtetasis V.B., të rikthyer vetëm në shumën 16,000 USD. Gjendja përpara transferimit në datën 1.7.2016 ka qenë 48,480,56 USD.

16.9.4 Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se burimi bazë i shumës prej 44,360 USD, të transferuar në datën 18.7.2016, duket se është nga transferta me këmbim e datës 27.7.2013, të shumës prej 126,500 euro në llogarinë në USD në kundërvlerë 166,980 USD.

16.9.5 Referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioni, konkretisht:

- Me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.1.2021, nga ISSH-ja, rezulton se personi tjetër i lidhur, shtetasi I.M, ka deklaruar marrëdhënie punësimi pranë shoqërisë “****” sh.p.k. duke nisur nga data 1.1.2012. Për periudhën janar 2012 – qershor 2013, të ardhurat neto të llogaritura rezultojnë në shumën 1,438,113 lekë.

- DRT Gjirokastrë, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.5.2023, ka depozituar pranë Komisionit edhe dokumentacionin në lidhje me aktivitetin financiar, si dhe për ndarjen e dividendit nga shoqëritë tregtare, në të cilat z. I.M ka rezultuar aksioner, konkretisht:

i) Shoqëria “****” sh.p.k. për periudhën 2009 – 2014 ka ndarë dividend në vitin 2009, në shumën 300,000 lekë dhe, në vitin 2010, në shumën 100,000 lekë, duke paguar detyrimet, përkatësisht 30,000 lekë dhe 10,000 lekë.

Nisur nga fakti që z. I.M për këtë periudhë ka qenë bashkaksioner me 65% të kuotave në shoqërinë “****” sh.p.k., vlera neto e përfituar nga shpërndarja e dividendit në periudhën 2009 – 2014 llogaritet në 234,000 lekë [(300,000 lekë + 100,000 lekë) – 40,000 lekë] * 65%.

Në pasqyrat financiare për periudhën 1.1.2013 – 31.12.2013, evidentohet fakti se shuma e detyrimit të akumuluar (borxh) e shoqërisë ndaj aksionerëve në datën 31.12.2013 është në vlerën 80,628,530 lekë dhe, në raport me përqindjen e kuotave të kapitalit (65%), huaja që z. I.M i ka dhënë kësaj shoqërie sa më sipër, llogaritet në vlerën 52,408,544 lekë.

ii) Për shoqërinë “****” sh.p.k., regjistruar në vitin 2014, ndonëse nuk është paraqitur informacion për shpërndarje dividendi, kjo shoqëri është regjistruar dhe ka krijuar të ardhura

pas krijimit të shumës që ka shërbyer për transfertën e çmimit të blerjes së apartamentit (korrik 2013).

iii) Për shoqërinë “****” sh.p.k., regjistruar në dhjetor 2009, me status pasiv në datën 7.3.2011, DRT Gjirokastër ka depozituar arkëtimet për dividend për periudhën 2009 – 2014, ku për vitin 2010 është arkëtuar shuma 866,700 lekë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar dhe dokumentuar që babai i saj (i cili zotëron 39% të kuotave të kapitalit në shoqërinë “****” sh.p.k.) ka tërhequr dividend në shumën 1,950,000 lekë në vitin 2010.

iv) Për shoqërinë “****” sh.p.k., regjistruar në vitin 2009, nuk është përcjellë informacion për shpërndarje dividendi për periudhën deri në vitin 2013, por në pasqyrat financiare për periudhën 1.1.2013 – 31.12.2013 evidentohet fakti se shuma e detyrimit të akumuluar (borxh) të shoqërisë ndaj aksionerëve në datën 31.12.2013 është pasqyruar në vlerën 120,235,981 lekë, dhe për periudhën 2009 – 2013 ky borxh/hua e aksionerëve është rritur me 96,615,316 lekë (120,235,981 lekë – 23,620,665 lekë), prej të cilave 50% i takojnë shtetasit I.M (në vlerën 60,117,990 lekë).

16.9.6 Shuma e të ardhurave nga dividendi të dokumentuara për periudhën 2009 – 2013 rezultojnë 2,184,000 lekë (234,000 lekë + 1,950,000 lekë).

16.9.7 Sa më sipër, pa llogaritur shpenzime për jetesë (referuar të dhënave të administruara nga Komisioni, shtetasi I.M ka qenë së bashku me 7 persona të tjerë në certifikatë familjare), pasuri të tjera të krijuara dhe ose shpenzime të tjera të kryera (përfshirë dhe jo vetëm shpenzime shkollimi, qiraje etj.), si dhe të ardhura të tjera, duket se nuk arrihet të dokumentohet mundësia financiare e babait të subjektit⁴ për krijimin e shumës 126,500 euro në datën 27.7.2013, e cila ka qenë burim për pagesën e këstit të parë të çmimit të blerjes së apartamentit në shumën 44,360 USD (në kundërvlerë 4,684,860 lekë⁵) në vitin 2016.

16.9.8 Në lidhje me pagesën e kësteve të çmimit të blerjes së këtij apartamenti, likuiduar në 5 këste në vitin 2018, në shumën totale 38,214.75 euro (konvertuar në vlerën 4,716,464 lekë)⁶ është bërë vlerësimi si më poshtë.

16.9.9 Komisioni, duke iu referuar informacionit nga ISSH-ja⁷, ka llogaritur të ardhurat e deklaruara nga paga për të cilat janë paguar detyrimet për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe TAP për periudhën korrik 2013 – dhjetor 2018, që kanë rezultuar në vlerën neto 5,652,795 lekë. Gjithashtu, në bazë të informacionit nga DRT Gjirokastër dhe DPT⁸, nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me të ardhurat nga shpërndarja e dividendëve për periudhën 2014 deri në datën 31.12.2018.

16.9.10 Nëse do të merren në konsideratë shpenzimet për jetesë minimalisht vetëm për shtetasin I.M për këtë periudhë, si dhe blerjen e automjetit (objekt shqyrtimi më poshtë në pikën 2 të këtij vendimi), pa llogaritur pasuri të tjera të krijuara, shpenzime të kryera, si dhe të ardhura të

⁴ Kjo analizë është në rezervë, pasi nuk janë përfshirë efektet financiare të shitblerjes së pasurive të paluajtshme, automjeteve, si dhe nuk janë përfshirë të ardhura nga investimet (për të cilat nuk janë identifikuar burimet e krijimit të shumës bazë të investuar), huadhëniet etj.

⁵ Kursi i këmbimit 1 USD = 105,61 lekë, datë 26.7.2013, referuar të dhënave *online* nga Banka e Shqipërisë.

⁶ Sipas kursit të këmbimit nga Banka e Shqipërisë, datë 31.12.2018 (1 euro = 123,42 lekë).

⁷ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.1.2021.

⁸ Referuar informacioneve nga DRT Gjirokastër me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.5.2023, dhe nga DPT-ja me shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2021.

tjera, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të dokumentojë burimin e të ardhurave të babait të saj për shlyerjen e kësteve të çmimit të blerjes së apartamentit në vitin 2018⁹.

16.9.11 Sa më sipër, duket se nuk është arritur dokumentimi nga subjekti i rivlerësimit i burimit të ligjshëm të të ardhurave të babait të saj për blerjen e apartamentit me sip. 102.6 m², në ***, Tiranë, dhe Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

16.10 Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e saj deklaroi se: *“...Konstatohet se analiza financiare e Komisionit në lidhje me të ardhurat e babait tim dhe anëtarëve të tjerë të familjes i referohet periudhës nga viti 1993 deri në qershor të vitit 2013. Ne nuk arritëm të identifikojmë asnjë rrethanë apo fakt, përfshirë ngjarje ekonomike ose jo, e cila do të çonte në një analizë vetëm për këtë periudhë. Kjo mospërputhje ekziston në lidhje me kohën në të cilën janë kryer veprimet për blerjen e apartamentit në datën 19.7.2016 dhe blerjen e automjetit në muajin tetor 2016, pasuri këto që çuan në riçeljen e hetimit pasuror dhe zgjerimin e tij në anëtarët e tjerë të familjes sime. Nuk është kryer asnjë blerje pasurie që lidhet me mua si subjekt dhe personat e tjerë të lidhur me mua në këtë periudhë. As nga ana e babait tim nuk rezulton të jetë kryer ndonjë veprim, i cili do të çonte në kryerjen e analizës financiare për periudhën 1999 – qershor 2013. Duke marrë parasysh faktin se deklarata Vetting është dorëzuar nga ana ime në datën 31.1.2017 dhe emërimi në detyrë në datën 6.11.2015, na rezulton një mospërputhje në logjikën e ndjekur nga Komisioni në analizën e kryer.*

*Në analizën financiare të bërë nga Komisioni nuk janë përfshirë të ardhurat nga shoqëria “***” sh.p.k. Konstatohet se në të ardhurat e përfshira në rezultatet e hetimit pas riçeljes nuk janë përfshirë të ardhurat që lidhen me shoqërinë “***” sh.p.k., për shkak se Komisioni e ka justifikuar se nga kjo shoqëri nuk janë shpërndarë dividendë, duke u bazuar në një raport për rritje kapitali me të ardhurat deri në vitin 2004, i cili ka ndodhur pas largimit të babait tim si ortak i kësaj shoqërie në vitin 2003. Ndërkohë, te po ky raport rezulton një fitim i pashpërndarë në shumën 7,000,000 lekë, ndërkohë që babai im i ka shitur kuotat në vlerën 34,000 lekë. Nuk ka logjikë që të shiten kuotat në vlerë shumë herë më të vogël se vlera e fitimit të pashpërndarë, nëse ortaku që shet kuotat nuk do të kishte marrë më parë fitimet e veta.*

Sipas çdo logjike të thjeshtë, duke iu referuar aktit të ekspertimit, minimalisht babai im do të përfitonte 34% të shumës së fitimeve të pashpërndara, që rezulton 2,380,000 lekë. Gjithsesi, eksperti konstaton një mospërputhje logjike, që rrjedh nga data kur është larguar babai im si ortak i kësaj shoqërie dhe datës kur ka ndodhur rritja e kapitalit, e marrë në konsideratë nga Komisioni. Ritheksojmë këtu faktin se sipas ekspertit deri në vitin 1999 legjislacioni tatimor nuk parashikonte tatim dividendi dhe se shpërndarjet e fitimeve kryheshin rregullisht, pa ndonjë detyrim për pagesë tatimesh.

Komisioni në rezultatet e hetimit shtesë shprehet se: “Kjo analizë nuk ka përfshirë të ardhurat nga interesat bankarë, për të cilët duket se nuk arrihet të dokumentohet burimi fillestar i shumës

⁹ Kjo analizë është në rezervë, pasi nuk janë përfshirë efektet financiare të shitblerjes së pasurive të paluajshme, automjeteve, si dhe nuk janë përfshirë të ardhura nga investimet (për të cilat nuk janë identifikuar burimet e krijimit të shumës bazë të investuar), huadhëniet etj.

së depozituar, si dhe gjendjet në llogari bankare dhe investimet në fonde investimi nga shtetasi I.M, për të cilat duket se nuk dokumentohet burimi i të ardhurave për krijimin e tyre”.

Për krijimin e fondit të investimit janë përdorur, ndër të tjera, edhe likuiditetet e përfituara nga arkëtimi i shumave të përcaktuara në kontratat e kaparit. Kjo provohet nëpërmjet kontratave të nënshkruara (qoftë ato noteriale, qoftë ato të firmosura në selinë e shoqërisë “****” sh.p.k.), por edhe nëpërmjet derdhjeve të bëra nga kapardhënësit apo për llogari te tyre në llogaritë bankare.

Të ardhurat nga kontrata e kaparit në lidhje me pasuri të paluajtshme janë të ardhura që nuk i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat, pasi në rastin e shitjes së pasurisë së paluajtshme nga shoqëria e ndërtimit paguhet taksë vendore për m² mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, sipas parashikimeve në nenin 28 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, në momentin e realizimit të shitjes përfundimtare.

Megjithatë, edhe nëse përdorimi i këtyre likuiditeteve nga ana e babait tim si administrator i kësaj shoqërie për investimin në fondin e investimit Raiffeisen Invest mund të jetë bërë në shkelje të rregullave për administrimin e shoqërive tregtare, kjo nuk mund të përbëjë arsye për të mos i llogaritur si të ardhura të ligjshme të ardhurat nga interesat bankarë.

Nga ana tjetër, mospërfshirja nga Komisioni në analizën financiare të të ardhurave nga interesat bankarë të fondit të investimit, është e pabazuar në ligj, pasi nenit D/3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon se: “Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore”.

Interesat bankarë mbi fondin e investimit, në kuptim të KSH janë të ligjshme, për ta është paguar tatimi i mbajtur nga banka sipas përcaktimit të nenit 58/1, shkronja “b” e ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i cili përcakton se: “Të ardhurat nga interesat janë objekt i mbajtjes së tatimit në burim kundrejt detyrimit tatimor përfundimtar, kur i paguhen një tatimpaguesi rezident ose një selie të përhershme në Republikën e Shqipërisë të një tatimpaguesi jorezident”.

Në një rast hipotetik, nëse pikërisht ky apartament për të cilin Komisioni vlerëson se nuk ka pasur burime të ligjshme për krijimin e tij, do të ishte dhënë me qira, për të cilin do të ishin paguar edhe detyrimet tatimore që rrjedhin nga qiradhënia, këto të ardhura të tatuara si do të konsideroheshin, të ardhura të ligjshme apo të paligjshme?

Në tërësinë e vet, raporti i ekspertimit paraqet të ardhurat dhe shpenzimet e vlerësuara për periudhën 1999 – 2016, periudhë brenda së cilës është bërë edhe pagesa e këstit të parë 40,000 euro të apartamentit dhe blerja e automjetit.

Sipas analizës financiare të përgatitur nga eksperti, diferenca të ardhura – shpenzime = 25,663,958 lekë.

Në analizën financiare shtesë janë përfshirë të ardhurat e realizuara nga gjyshi im si bujk për periudhën e marrë në shqyrtim, në vlerën 7,192,040 lekë, për këtë fakt depozitohet deklaratën noteriale të shtetasve T.M dhe N.M. Edhe po t’i heqim këto të ardhura, rezulton vlera prej 18,471,918 lekësh. Gjithashtu, me këtë balancë pozitive prej 2,380,000 lekësh si e ardhur nga shoqëria “****” sh.p.k. përsëri diferenca del në vlerën 16,091,918 lekë. Ky është një bilanc në

masë të konsiderueshme për justifikimin e pagesës së këstit të parë të apartamentit dhe për blerjen e automjetit.

Në lidhje me pagesën e kësteve të tjera të çmimit të blerjes së këtij apartamenti në shumën totale 38,214,75 euro, shumë kjo e likuiduar në këste, 5 këste në vitin 2018, janë vërtetuar pagesa e tatimit për periudhën tetor 2016 – dhjetor 2018. Të ardhurat për këtë periudhë janë në vlerën 20,743,577 lekë, të cilat tejkalojnë disa herë vlerën e mbetur prej 38,907 euro të apartamentit. Për më tepër, pika “b” e objektit të riçeljes së hetimit dhe analiza e mundësisë financiare të babait tim në cilësinë e personit të lidhur, për krijimin e pasurive në përdorim apo pronësinë time, sikurse e kam bërë me dije edhe në përgjigjet e pyetësorëve të mëparshëm, këtë apartament e kam pasur në përdorim së bashku me motrat e mia, të cilat jetojnë në Tiranë për arsye studimi. I paraqes Komisionit për të provuar këtë fakt dokumentacionin e marrë nga Universiteti Politeknik i Tiranës, sipas të cilit E.M është studente në vitin e tretë – A, sistemi me kohë të plotë, në degën Inxhinieri Ndërtimi, ndërsa Xh.M nga viti 2015 – 2017 ka qenë studente në Universitetin Epoka dhe nga viti 2017 – 2024 ka mbaruar studimet në Degën Arkitekturë pranë Universitetit Politeknik të Tiranës. Në këto kushte, Komisioni të vlerësojë përdorimin e apartamentit në raport me pjesën time takuese të përdorimit. Sa më sipër, vlerësoj se kam përmbysur barrën e provës lidhur me gjetjet e Komisionit për kriterin e pasurisë, duke theksuar edhe një herë që unë nuk kam asnjë pasuri përveç automjetit që e përdor nga viti 2016, duke marrë në konsideratë edhe parimin e proporcionalitetit”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

16.11 Trupi gjykues, pasi administroi provat e rezultuara gjatë hetimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në lidhje me prapësimet e saj me shkrim dhe në seancën dëgjimore, konstaton se subjekti ka bërë një deklaram të saktë e të mjaftueshëm të pasurisë që ka në përdorim. Subjekti është emëruar në detyrën e saj si ndihmëse ligjore në datën 6.11.2015 dhe pasuria është porositur nga babai i saj në datën 19.7.2016, pra rreth 8 muaj nga koha e emërimit të saj. Elementi i dytë i marrë në analizë është e drejta e përdorimit, për të cilën subjekti ka bërë një deklaram të plotë dhe të saktë, duke saktësuar se kjo si pasuri ishte përdorur për nevojat e studimit dhe të punësimit dhe të fëmijëve të tjerë të familjes, të cilët studiojnë dhe punojnë në Tiranë. Subjekti ka përmbushur detyrimin ligjor, duke e deklaruar këtë pasuri në përdorim.

16.12 Lidhur me elementin tjetër të analizës, burimi i ligjshëm i krijimit të saj nga personi i lidhur, trupi gjykues çmon se nisur nga fakti që është e provuar se pagesa e kësteve të kësaj pasurie është bërë nëpërmjet një transaksioni bankar nga llogaria në Raiffeisen Invest, në analizën financiare të Komisionit, duke marrë në konsideratë faktin se burimi i krijimit të saj nuk janë vetëm të ardhurat e personit të lidhur si aksioner apo i punësuar, por dhe interesat e kësaj llogarie, trupi gjykues çmon se vlera e këtyre interesave është një e ardhur e tatuar e, për pasojë, burimi i krijimit të kësaj pasurie është i ligjshëm. Nga hetimi rezultoi se të ardhurat neto nga interesat bankarë në Raiffeisen Invest nga periudha shkurt 2013 – korrik 2016 janë në vlerën 12,383,909 lekë.

16.13 Komisioni çmon se edhe nëse do të konsiderohet si e tillë mungesa e burimeve të ligjshme që rezulton nga analiza financiare e kryer, duke mos përfshirë të ardhurat e babait nga interesat bankarë, nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë që e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

16.14 Në mungesë të ndonjë të dhëne që të bën të dyshosh se subjekti i vlerësimit me deklarinimin e të ardhurave të babait të saj ka synuar të mashtrijë organet e rivlerësimit ose ka deklaruar qëllimisht ndryshe në mënyrë të rreme, trupi gjykues çmon se pasuria e deklaruar ka si burim të ardhurat e babait, të krijuara kohë më parë se subjekti të kishte statusin e ndihmësit ligjor. Këto të ardhura rezultojnë nga burime të ligjshme dhe transaksione bankare, ku i vetmi element që nuk përmbush kushtet e nenit D, pika 3, është pagesa e tatimeve. Kjo situatë faktike nuk është e drejtë të konsiderohet si një mangësi apo defekt, i cili të prodhojë pasoja për subjektin e rivlerësimit, vendosjen e masës së shkarkimit të saj nga detyra. Kjo mangësi, duke qenë se është e vetmja e konstatuar lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe, e vendosur në kontekstin e mësipërm, nuk vlerësohet se mund të prodhojë në mënyrë proporcionale vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra si një masë e nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

16.15 Ky qëndrim i trupit gjykues është në përputhje me vendimin nr. 6, datë 17.3.2022, ku, ndër të tjera, arsyetohet se: *“Situata e përshkruar më lart vë subjektin dhe organet e rivlerësimit në kushtet e pamundësisë për të kontrolluar vërtetësinë e deklarinimeve të tij dhe të burimeve të ligjshme të të ardhurave për krijimin e pasurisë së përshkruar më lart, e cila rezulton të jetë krijuar në vitet... Rezultati negativ i përcaktuar në vendimin e Komisionit lidhur me këtë periudhë, por edhe sipas analizës së bërë në Kolegj... vjen si pasojë e moskonsiderimit të të ardhurave të krijuara në vitet ... Kolegji, në vijim, do të arsyetojë mbi peshën dhe ndikimin që kjo rrethanë do të duhet të ketë mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke konsideruar të gjitha çështjet për të cilat Komisioni ka konkluduar me vendimmarrjen e tij. Kolegji mban në konsideratë faktin se, megjithëse provat e disponueshme nga institucionet shtetërore nuk konfirmojnë legjitimitetin e të ardhurave të pretenduara prej subjektit, ... në mungesë të ndonjë treguesi që të bën të dyshosh se subjekti i vlerësimit, me deklarinimin e të ardhurave të tilla ka synuar të mashtrijë organet e rivlerësimit ose ka deklaruar qëllimisht ndryshe në mënyrë të rreme, vlerëson se kjo situatë faktike nuk çmohet se është e drejtë të konsiderohet si një mangësi apo defekt i cili të prodhojë për subjektin e rivlerësimit si pasojë vendosjen e masës së shkarkimit të tij nga detyra. Kjo mangësi mbetet e vetmja e konstatuar lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe, e vendosur në kontekstin e mësipërm, nuk vlerësohet se ajo mund të prodhojë në mënyrë proporcionale vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra, si një masë e nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. ...Në këtë vlerësim, Kolegji mban në konsideratë edhe faktin që pasuria rezulton të jetë krijuar dhe të ketë ekzistuar para se subjekti i rivlerësimit të ishte emëruar në detyrën e prokurorit”*. Gjithashtu ky qëndrim i trupit gjykues është në përputhje me vendimin nr. 20, datë 3.5.2023, ku, ndër të tjera, arsyetohet se: *“Pamundësia për të provuar krijimin e tyre apo standardin e të ardhurës së ligjshme sipas Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që nuk shoqërohet me konstatimin e veprimeve të qëllimshme për të rritur artificialisht të ardhurat e deklaruara, nuk është një konkluzion që ngarkon me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në mënyrë autonome. Vetëm mungesa e provueshmërisë së një pjese të të ardhurave, e pashoqëruar me deklarinime të rreme lidhur me to, pavarësisht faktit që përfaqëson një deklarinim të pasaktë dhe jo në përputhje me kuadrin ligjor, në kuptim të parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të shërbejë si një shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në rast se ai*

justifikon me të ardhurat e provuara si të ligjshme, krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve...”.

16.16. Në përfundim, për sa më sipër, Komisioni çmon se edhe mungesa e burimeve të ligjshme që mund të rezultojë nga analiza financiare e kryer, duke mos përfshirë në të të ardhurat nga interesat bankarë, nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë që e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

17. Automjet tip “Mercedes-Benz, B180CDI”, vit prodhimi 2009

17.1 Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* këtë automjet të blerë në shumën 3,500 euro dhe shpenzime zhdoganimi në shumën 104,369 lekë “nga babai me të ardhurat e tij personale” (pjesa takuese 100%).

17.2 Gjithashtu në dosjen *Vetting*, subjekti ka depozituar ndër të tjera edhe: (i) certifikatë pronësie (në emër të saj) të automjetit tip “Mercedes-Benz” me targë AA *** OK; (ii) aktmarrëveshje të blerjes për automjete motorike të përdorura në shtetin gjerman, datë 16.10.2016 (datë dorëzimi 19.10.2016); (iii) deklaratë doganore nr. ***, datë 21.10.2016, me marrës/importues shtetasen Klerona Meçi dhe detyrim 104,369 lekë.

17.3 Referuar informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja, rezulton se në bazë të “Kaufvertrag” (aktmarrëveshje e blerjes për automjete motorike të përdorura) znj. Klerona Meçi (në cilësinë e blerëses) ka blerë në datën 16.10.2016 nga shoqëria “****”, Gjermani, automjetin tip “Mercedes-Benz ****”, vit prodhimi 2009, kundrejt çmimit 3,500 euro.

17.4 Në deklaratën doganore ***, datë 21.10.2016, në cilësinë e marrësit/importuesit të këtij automjeti është subjekti i rivlerësimit. Me këtë deklaratë autoriteti doganor ka bërë rivlerësim të çmimit të blerjes së mjetit afro 2 herë më shumë nga çmimi i blerjes së deklaruar, ku janë shlyer detyrimet doganore në shumën 199,347 lekë.

17.5 Sa më sipër, shuma e llogaritur/paguar nga subjekti/babai i saj rezulton në vlerën 678,427 lekë (3,500 euro * 136,88 lekë/euro + 199,347 lekë).

17.6 Në bazë të dokumentacionit të administruar, konkretisht kartelës së regjistrimit të këtij automjeti në shtetin gjerman (karta e regjistrimit të automjetit, pjesa II), rezulton se në datën 19.10.2016 është lëshuar leje dhe targa provizore RE *** A në emër të shtetasit P.N (pronar), me adresë Lagjja Nr. ***, ***, Sarandë.

17.7 Dega Doganore Kakavijë, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.10.2023, ka vënë gjithashtu në dispozicion të Komisionit praktikën e zhdoganimit të këtij mjeti, por nuk ka informuar për personin që ka sjellë automjetin nga jashtë vendit (vërtetim hyrjeje ose vërtetim nga sistemi TIMS).

17.8 Sa më sipër, duket se ka mospërputhje të personit që i ka shitur këtë automjet subjektit të rivlerësimit, pasi në kartën e regjistrimit të këtij automjeti në Gjermani pronar rezulton shtetasi P.N, ndërsa në kontratën e paraqitur nga subjekti është shoqëria “****”, për më tepër që subjekti nuk ka udhëtuar në Gjermani në këtë periudhë.

17.9 Gjithashtu, Komisioni ngre disa paqartësi që lidhen me:

- i) çmimin e blerjes së këtij automjeti në Gjermani dhe mënyrën, kohën e pagesës së këtij çmimi;
- ii) personin që ka paguar detyrimet doganore në datën 21.10.2016, pasi në deklaratën përkatëse doganore është subjekti i rivlerësimit në cilësinë e marrësit/importuesit (në emër të të cilit është llogaritur detyrimi doganor), ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 1 subjekti ka deklaruar që babai ka paguar shumën 104,369 lekë detyrime doganore.

17.10 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se: “...z. P.N, në emër të të cilit është lëshuar leja dhe targa provizore, është një mik i babait tim, i cili ka bërë blerjen e këtij automjeti në Gjermani për llogari të babait tim dhe e ka sjellë këtë mjet në Shqipëri.

Z. P.N na sqaron se leja dhe targa provizore lëshohen gjithmonë në Gjermani në emër të personit që është prezent dhe që merr mjetin në dorëzim dhe që e sjell atë në Shqipëri, ndërkohë që kontrata bëhet në emër të personit që do të jetë pronari i ri i këtij automjeti. Në rastin konkret, z. P.N ka qenë personi që ka shkuar në Gjermani dhe ka marrë mjetin në dorëzim dhe e ka sjellë atë në Shqipëri. Paratë për blerjen e mjetit i janë dhënë z. P.N nga babai im, prandaj dhe kontrata në Gjermani dhe në vazhdim dhe zhdoganimi janë kryer në emrin tim”.

17.11 Nisur nga fakti që nga autoriteti doganor vlera statistikore për llogaritjen e detyrimeve doganore për zhdoganimin e këtij automjeti është rivlerësuar/rregulluar (në rritje me koeficient 1.910), shoqëruar me paqartësitë në dokumentacion si në blerje të mjetit, ashtu edhe në transportimin, zhdoganimin dhe pagesën e detyrimeve doganore, Komisioni vlerëson se subjekti duket se nuk ka vërtetuar shumën e paguar dhe mënyrën e pagesës për këtë automjet nga babai i saj.

17.12 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Analizë e burimit të të ardhurave dhe mundësia financiare

17.13 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se: “*Autovetura është blerë nga babai me të ardhurat e tij personale...*”.

17.13.1 Në zbatim të përcaktimeve ligjore (udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm pranë ILDKPKI-së), subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie nga babai i saj. Për këtë, nga Komisioni iu kërkua deklarimi dhe dokumentimi i burimit të të ardhurave të babait për blerjen e automjetit objekt vlerësimi.

17.13.2 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se: “*...Për sa i përket burimit të të ardhurave, vlen sqarimi dhe informacioni i detajuar i dhënë për pyetjen nr. 1*”.

17.13.3 Sa më sipër, duket se subjekti nuk ka bërë një përcaktim specifik të burimit të të ardhurave të babait të saj për blerjen e automjetit, por e ka përfshirë në burimin financiar të paraqitur për blerjen e apartamentit në ***, Tiranë, ku shpjegon ndër të tjera se: “*...kanë qenë të ardhurat nga veprimtaria që lidhen me aktivitetin në fushat e biznesit të përshkruara më sipër dhe shitja e pasurive të paluajtshme të familjes, shfrytëzimi i pasurive të paluajtshme në emër të bizneseve, të ardhura të tjera që lidhen me pagat e babait dhe anëtarëve të tjerë të familjes...*”.

17.13.4 Në vijim të analizës së Komisionit, pasqyruar më sipër për burimin e të ardhurave dhe mundësinë financiare të babait të subjektit, për pagesën e kësteve të çmimit të blerjes së apartamentit, të ardhurat neto nga paga të deklaruara/llogaritura për të cilat janë paguar detyrimet për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe TAP, referuar informacionit nga ISSH-ja¹⁰ për periudhën korrik 2013 – shtator 2016 rezultojnë rreth 3,385,000 lekë, ndërsa shpenzimet për jetesë për këtë periudhë llogariten rreth 691,000 lekë për një person¹¹.

17.13.5 Gjithashtu, në bazë të informacionit nga DRT Gjyrokastër dhe DPT-ja¹², nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me të ardhura nga shpërndarja e dividendëve për periudhën 2014 deri në datën e blerjes së automjetit.

17.13.6 Nisur nga faktet që: (i) pagesat për blerjen e këtij automjeti janë kryer *cash*; (ii) aktivitetit të zgjeruar financiar të babait të subjektit (si i punësuar/administrator dhe aksioner në disa shoqëri tregtare), me lëvizje të konsiderueshme vlerash monetare (blerje/ shitje pasurish, investime financiare, marrje/dhënie huash, si dhe shpenzime të ndryshme), një pjesë e cilave duket se kanë qenë me burim të paqartë të krijimit dhe të destinacionit të tyre; (iii) mungesës së informacionit për numrin e personave në ngarkim të shtetasit I.M, Komisioni vlerëson që për analizën financiare të konsiderojë, duke pasqyruar me rezervë, kontributin e deklaruar nga babai për këtë pasuri, si dhe mundësinë financiare të babait të subjektit për pagesën e shumës së blerjes së automjetit, duke u mbështetur në shumën e dokumentuar të të ardhurave të tij nga paga, por subjekti duhet të provojë saktësisht burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e saj.

17.3.7 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

17.4 Subjekti është shprehur: *“Sa i takon blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz B-Class”, me targë AA *** OK, sqaroj se babai im e ka porositur këtë automjet tek shtetasi P.N, i cili ka qenë përgjegjës për transportin e këtij automjeti deri në hyrje të territorit shqiptar dhe ka qenë personi që ka futur automjetin në territorin shqiptar. Nga ky moment, të gjitha dokumentet që lidhen me pagesën e detyrimeve doganore apo edhe regjistrimin e tij janë kryer në emrin tim si përfutuese e këtij automjeti. Pagesat si për blerjen e automjetit, edhe për shlyerjen e detyrimeve doganore janë bërë në emër dhe për llogarinë time nga babai im. Përveç aktit të ekspertimit në të cilin është trajtuar kjo çështje, bashkëlidhur do gjeni deklaratën e z. P.N të bërë me kërkesën time”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

17.5 Trupi gjykues, pasi administroi provat e rezultuara gjatë hetimit, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në prapësimet e saj me shkrim dhe në seancën dëgjimore, konstaton se subjekti ka bërë një deklaram të saktë e të mjaftueshëm të pasurisë që ka në pronësi. Duke qenë se subjekti

¹⁰ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.1.2021.

¹¹ Në mungesë të informacionit për numrin e personave në ngarkim të shtetasit I.M, të shpenzimeve të tjera (përfshirë dhe jo vetëm qira, shkollim etj.); Referuar certifikatës familjare të datës 23.5.2014, rezultojnë 8 persona (shtetasi I.M, nëna, babai i saj, bashkëshortja dhe 4 fëmijë, përfshirë subjektin e rivlerësimit).

¹² Informacion nga DRT Gjyrokastër me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.5.2023, dhe nga DPT-ja me shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2021.

ka deklaruar se si burim për krijimin e kësaj pasurie janë të ardhurat e babait të saj, të analizuara në pasurinë në pikën 16, arsyetimi i bërë për burimin e ligjshëm të kësaj pasurie është relevant edhe për këtë pasuri.

18. Llogari bankare në Credins Bank, në shumën 12,264.54 lekë

18.1 Subjekti ka shpjeguar në deklaratën *Vetting* se është llogaria për efekt të punësimit si ndihmëse ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme.

18.2 Referuar të dhënave nga Credins Bank, me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.3.2021, rezulton se kjo llogari është hapur në datën 1.12.2015 dhe gjendja në llogarinë e pagës së subjektit në datën 31.1.2017 është në vlerën 12,160 lekë.

18.3 Burimi i të ardhurave për krijimin dhe ecurinë e vlerave monetare në këtë llogari page është pasqyruar nga Komisioni në analizën paraprake të treguesve financiarë¹³.

Analiza paraprake e treguesve financiarë

18.4 Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiare për kategoritë pasuri, detyrime, të ardhura dhe shpenzime për subjektin për periudhën nga fillimi i detyrës në datën 6.11.2015, deri në kohën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, më 31.1.2017 (mënyrë kumulative), mbështetur në dokumentacionin justifikues ligjor të administruar, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe jurisprudencës së Kolegjit, duke analizuar burimin e deklaruar të të ardhurave për krijimin e pasurive (të paluajtshme, të luajtshme dhe likuiditete) dhe mbulimin e shpenzimeve të ndryshme.

Periudha		6.11.2015- 31.01.2017
Perberja familjare (certifikate)/nr. persona		1
KATEGORI	NËNKATEGORI	
ASETE	Autoveturë Mercedes Benz B Class, blerë me kontratë datë 19.10.2016 në shumën 3500 Eu, shpenzime doganore në vlerë 199347 lekë në datë 21.10.2016 ;	678427
	Likuiditete (ndryshim gjendje, shtesa/pakësime) ;	-137939
	TOTALI	540488
DETYRIME		0
	TOTALI	0
TE ARDHURA	Te ardhura nga mardheniet e punësimit te shoqeria "**** " shpk, periudha nëntor 2015-janar 2016 sipas informacionit nga ISSH ;	28416
	Te ardhura neto nga mardheniet e punësimit si ndihmes ligjor ne Prok. e Përgjithshme sipas Credins bank për periudhën 01.12.2015-31.01.2017 ;	964597
	Të ardhura të tjera, dhurim nga babai për blerjen e autoveturës deklaruar në pyetësorin nr.1 ;	583449
	TOTALI	1576462
SHPENZIME	Shpenzime transporti dhe qëndrimi jashtë vendit për periudhën 6.11.2015-31.01.2017 ;	40774
	Shpenzime për regjistrimin/ sigurime automjeti Mercedes Benz ;	27167
	Shpenzime për qira deklaruar deri në datë 31.12.2016 ;	280000
	Shpenzime me MC ne Credins ;	154610
	Shpenzime minimale per konsum sipas INSTAT, ILDKPKI (6.11.2015-31.01.2017) ;	288478
	TOTALI	791029
	ANALIZA FINANCIARE	Viti 2017
	1 Te ardhura	1576462
	2 Asete	540488
	3 Detyrime	0
	4 Shpenzime	791029
	Balanca e fondeve (1-2+3-4)	244945

¹³ Në aneks bashkëlidhur relacionit.

18.4.1 Sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi financiare nga të ardhurat e dokumentuara për mbulim të shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 6.11.2015 – 31.1.2017.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

18.5 Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj dhe ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Subjekti nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të saj.

18.6 Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka justifikuar bindshëm pasuritë e saj, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, të neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

Në lidhje me deklarimin e personave të lidhur në deklaratën Vetting

18.7 Në kuadër të procesit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka bashkëlidhur deklaratën e pasurisë së personave të lidhur sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016.

18.7.1 Nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit është shkëputur nga trangu familjar në datën 24.10.2016¹⁴, si dhe nga kërkesat ligjore të parashikuara nga neni 31/1 i ligjit nr. 84/2016¹⁵, Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë mosdorëzimin e deklaratave të pasurisë së personave të lidhur, që rezultojnë në certifikatën familjare, në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016.

18.7.2 Në përgjigje të pyetjes, subjekti shpjegon se: *“Ligji nr. 84/2016 është miratuar në datën 30.8.2016, i cili parashikohej të hynte në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ky ligj u publikua në datën 23.9.2016 dhe duhej të hynte në fuqi në datën 8.10.2016, sipas parashikimit të nenit 71 të këtij ligji. Ndërkohë, neni 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, parashikonte se afati për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës së pasurisë ishte 30 ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Pra, afati teorik i llogaritur për dorëzimin e kësaj deklarate ishte data 8.11.2016. Një grup prej 31 deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe pezullimin e zbatimit të tij deri në dhënien e një vendimi përfundimtar nga kjo Gjykatë.*

Gjykata Kushtetuese, me vendimin e ndërmjetëm të datës 25.10.2016, të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve, vendosi pezullimin e efekteve të ligjit nr. 84/2016 deri në shqyrtimin e kërkesës. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, vendosi “Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për rrjedhojë, afati për dorëzimin e deklaratës së pasurisë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese ishte data 19.2.2017.

¹⁴ Vetëdeklaruar në pyetësin standard, në përgjigje të pyetjes nr. 3.

¹⁵ Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë sipas shtojcës nr. 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së. Deklarata e pasurisë plotësohet nga subjekti i rivlerësimit që mbart detyrimin për deklarim të pasurisë së tij, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe të fëmijëve madhorë dhe të çdo personi të përmendur në certifikatën familjare në bazë të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Duke qenë se nuk kam qenë më parë subjekt deklarimi me detyrimin e plotësimit të deklarimit periodik të pasurisë, ishte hera e parë që plotësoja një deklaratë të tillë. Për këtë shkak, kam kërkuar verbalisht asistencën e punonjësve të ILDKPKI-së, të cilët më sqaruan se subjekte të lidhura me detyrim deklarimi nuk janë prindërit, për aq kohë sa në momentin e deklarimit nuk bëjnë pjesë në certifikatën familjare. Sikurse përmendet edhe në pyetjen tuaj, unë jam ndarë nga trangu familjar në datën 24.10.2016, dhe dorëzimi i deklaratës së pasurisë pranë ILDKPKI-së është bërë në datën 31.1.2017. Në kushtet kur deklarimi i pasurisë bëhej për gjendjen e pasurive në momentin e deklarimit, në datën 31.1.2017, kur kam plotësuar deklaratën e pasurisë, kam qenë e ndarë nga trangu familjar”.

18.7.3 Në analizë të kuadrit ligjor, rezulton e provuar se ligji nr. 84/2016 u miratua në datën 30.8.2016 dhe u botua në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 23.9.2016, dhe hyri në fuqi në datën 8.10.2016.

18.7.4 Sipas nenit 31 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së.

18.7.5 Referuar shtojcës 2 të ligjit, deklarata e pasurisë plotësohet nga subjekti i rivlerësimit që mbart detyrimin për deklarim të pasurisë së tij, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesi/es dhe të fëmijëve madhorë për çdo person të përmendur në certifikatën familjare, në bazë të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

18.7.6 Në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka qenë në një trung familjar me persona të tjerë madhorë, të cilët duhet të plotësonin deklaratën e pasurisë së personit të lidhur.

18.7.7 Për sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi barrën e provës pasi duket se subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm në deklaratën *Vetting*, duke shmangur nga deklarimi dhe kontrolli pasuritë e familjarëve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

18.8 Subjekti ka shpjeguar ndër të tjera se: “...*Duke qenë se unë nuk kam qenë më parë subjekt deklarimi me detyrimin e plotësimit të deklarimit periodik të pasurisë, ishte hera e parë që plotësoja një deklaratë të tillë. Për këtë shkak, kam kërkuar verbalisht asistencën e punonjësve të ILDKPKI-së, të cilët më sqaruan se subjekte të lidhura me detyrim deklarimi nuk janë prindërit, për aq sa në momentin e deklarimit nuk bëjnë pjesë në certifikatën familjare. ...unë jam ndarë nga trangu familjar në datën 24.10.2016 dhe dorëzimi i deklaratës së pasurisë pranë ILDKPKI-së është bërë në datën 31.1.2017. ...Në kushtet kur deklarimi i pasurisë bëhej për gjendjen e pasurive në momentin e deklarimit, në datën 31.1.2017, kur kam plotësuar deklaratën e pasurisë, kam qenë e ndarë nga trangu familjar. ...Ky mosdeklarim lidhet me mënyrën e të kuptuarit të hyrjes efektive në fuqi të ligjit nr. 84/2016 dhe me orientimet që kam marrë në kohën e plotësimit të deklaratës, pasi sikurse kam sqaruar më parë, nuk kam qenë kurrë subjekt deklarimi dhe deklarimi *Vetting* ka qenë deklarimi i parë i plotësuar nga ana ime”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

18.9 Trupi gjykues, pasi administroi provat e rezultuara gjatë hetimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në lidhje me prapësimet e saj me shkrim dhe në seancën dëgjimore, konstaton se:

18.9.1 Nga aktet e administruara gjatë hetimit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë përbërëse e familjes prindërore deri në datën 28.10.2016, ndërsa pas kësaj date gjendja familjare përbëhet vetëm nga subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues vëren se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, në datën 8.10.2016 subjekti i rivlerësimit ka qenë në të njëjtën certifikatë familjare me prindërit. Për efekt të këtij ligji, bazuar në parashikimet e pikës 13 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, prindërit e subjektit të rivlerësimit, për shkak të qenies në të njëjtën certifikatë familjare, konsiderohen persona të lidhur që kanë pasur detyrimin për të deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting*, duke bashkëlidhur të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre. Ndarja e subjektit të rivlerësimit nga trangu familjar disa ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 nuk ka përjashtuar nga detyrimi ligjor për deklarimin e pasurive në deklaratën *Vetting* prindërit e saj, të cilët kanë qenë pjesë e certifikatës familjare në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Trupi gjykues vëren se është përbërja e certifikatës familjare për gjithë periudhën e rivlerësimit, 8.10.2013 – 8.10.2016, ajo që përcakton rrethin e personave të lidhur që duhet të deklarojnë në kuptim të nenit 3, pika 13, dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, pavarësisht pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se prindërit e subjektit janë persona të lidhur dhe, me mosdeklarimin e tyre në deklaratën *Vetting*, subjekti ka shmangur detyrimin për deklarim të pasurisë dhe të interesave private të personave të lidhur. Sa më sipër, subjekti ka bërë një deklarim të pasaktë në deklaratën *Vetting*, pasi nuk ka deklaruar pasuritë e familjarëve të saj, të cilët në kuptim të ligjit nr. 84/2016 kishin detyrimin që të deklarorin interesat pasurorë në kuadër të procesit të rivlerësimit.

18.9.2 Trupi gjykues çmon se, duke qenë se analiza financiare e pasurisë së deklaruar nga subjekti në përdorim dhe në pronësi rezulton me burime të ligjshme dhe nisur nga fakti se subjekti nuk ka qenë asnjëherë subjekt deklarimi dhe pasuritë e disponuara nga ajo në përdorim e pronësi rezultojnë të krijuara me burime të ligjshme, kjo pasaktësi duhet të vlerësohet bazuar në parimin e proporcionalitetit.

Konkluzion përfundimtar për kriterin e pasurisë

18.10 Komisioni vlerëson në lidhje me pasurinë e subjektit të rivlerësimit në një optikë të përgjithshme, sipas standardit kushtetues të parashikuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës të “shpjegimit bindshëm” të pasurisë, duke zbatuar parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit në kuptim të parashikimit të nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili detyron organet e rivlerësimit që në mënyrë diskrecionale, por të arsyetuar e të shpjeguar, të shqyrtojnë procesin e rivlerësimit të një subjekti, duke konsideruar zbatimin e këtyre parimeve të së drejtës administrative të aplikueshme.

18.11 Bazuar edhe në parimin e objektivitetit, i cili parashikohet nga neni 14 i Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit “*Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe u japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative*”, Komisioni vlerësoi se të gjitha rrethanat në mënyrë thelbësore lidhen me të ardhurat e babait të subjektit, të ardhura këto të përfituara para se subjekti të kishte statusin e subjektit të rivlerësimit.

18.12 Komisioni vlerësoi rrethanat e analizuar në arsyetimin e këtij vendimi në harmoni dhe në raport me të gjitha çështjet e tjera, të cilat u trajtuan në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit në dritën e parimit të proporcionalitetit, parashikuar në

nenin 12 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: “1. Çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale ose mund të cenojë interesa legjitime, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit. 2. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është: a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitime të palës; b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë”.

18.13 Në mungesë të ndonjë të dhëne, që të bën të dyshosh se subjekti i vlerësimit me deklarin e të ardhurave të tilla ka synuar të mashtrtojë organet e rivlerësimit ose ka deklaruar qëllimisht ndryshe në mënyrë të rreme, trupi gjykues çmon se pasuria e deklaruar ka si burim të ardhurat e babait të subjektit, të krijuara kohë para se ajo të ushtronte funksionin e ndihmësit ligjor. Gjithsesi, të ardhurat për krijimin e pasurisë në përdorim dhe në pronësi të subjektit rezultojnë nga burime të ligjshme. Pasaktësia në deklaratën *Vetting* lidhur me pasuritë e personit të lidhur është e vetmja gjetje e konstatuar lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe, e vendosur në kontekstin e mësipërm, nuk vlerësohet se mund të prodhojë në mënyrë proporcionale vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra, si një masë e nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

18.14 Ky qëndrim i trupit gjykues është në përputhje me vendimin nr. 6, datë 17.3.2022, të Kolegjit.

18.15 Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet të marrë në konsideratë si vijon:

- i. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj në përdorim dhe pronësi, siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Subjekti nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim të saj.
- iii. Mungesa e deklaramit të pasurisë së personit të lidhur, si e vetmja gjetje në kuadër të vlerësimit të pasurisë së subjektit, nuk është në atë shkallë sa të përbëjë shkak për shkarkim, sipas pikës 3 të nenit 61 dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia.
- iv. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Klerona Meçi ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

19. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK), si institucioni kompetent për kontrollin e figurës, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016 “Për

rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka paraqitur pranë Komisionit raportin fillestar nr. *** prot., datë 30.10.2017.

19.1 AKSIK-ja nëpërmjet raportit fillestar mbi kontrollin e figurës, me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2017, i deklasifikuar plotësisht¹⁶, informon se: *“Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.*

Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës. Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të kimit të organizuar.

Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës. Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të kimit të organizuar”.

19.2 Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit, znj. Klerona Meçi. Nga hetimi administrativ i kryer, Komisioni u informua me shkresën *** prot., datë 31.5.2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, se ndaj personit të lidhur me subjektin (babai), z. I.M, ka regjistruar procedimin penal nr. *** të vitit 2014 për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

19.3 Gjatë hetimit, subjekti është pyetur nëse ka pasur detyrimin të deklarojë në deklaratën e kontrollit të figurës lidhur me procedimet penale të babait të saj. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar: *“Në momentin e plotësimit të deklaratës nuk kam qenë në dijeni të faktit se ndaj babait tim ka pasur ndonjë procedim penal, pasi për shkak të moshës relativisht të re babai nuk më ka vënë në dijeni në atë kohë. Për këtë fakt jam informuar nga im atë për shkak të pyetjes suaj. Nëse do kisha dijeni në momentin e plotësimit të deklaratave lidhur me procesin e rivlerësimit, do ta kisha deklaruar, pasi kam qenë dhe jam e vetëdijshme që është një fakt që nuk mund të fshihet. Nisur nga pyetja juaj, kemi kërkuar informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, e cila na ka vënë në dispozicion informacionin se nga regjistri i veprave penale dhe kallëzimeve penale rezulton se ndaj shtetasit I.M janë regjistruar çështjet si më poshtë:*

- 1) Procedim penal nr. ***, datë 26.5.2014, për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, i cili është pushuar në datën 30.12.2014;*
- 2) Kallëzim penal nr. ***, datë 19.8.2015, për veprën penale, parashikuar nga neni 199 i Kodit Penal, për të cilin me vendimin e datës 24.8.2015 është vendosur mosfillimin i procedimit penal.*

*Sa i takon procedimit penal nr. ***, datë 26.5.2014, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër na është vënë në dispozicion kopje e fletës së regjistrimit të “regjistrimit të veprave penale”, ku rezulton se në kolonën ku shënohet emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale, nuk është i shënuar emri i shtetasit I.M”.*

¹⁶ Vendim nr. 304, datë 5.10.2023, i KDZH-së.

19.4 Komisioni administroi dhe mori në shqyrtim dosjen penale që i përket procedimit penal nr. ***/2014 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.

19.5 Nga hetimi rezultoi se në datën 26.5.2014, nga ana e Policisë Gjirokastër, bazuar në nenin 293¹⁷ të Kodit të Procedurës Penale, është referuar vepra penale në organin e prokurorisë e konkretisht, duke parashtruar se: “Drejtoria për krimin ekonomik dhe financiar disponon informacione në lidhje me shtetasin I.T.M, i datëlindjes 9.7.1967, i cili ka kryer transaksione të shpeshta dhe në vlera të konsiderueshme. Nga referimi rezulton se ai është ortak dhe përfaqësues ligjor në disa shoqëri tregtare, në të cilat janë kryer transaksione të shumta, kryesisht me përshkrimin “Likuidim faturash dhe situacione punimesh”. Kallëzimi penal është bërë se ka dyshime të bazuara se shtetasi I.M, i biri i T.M dhe A.M, i datëlindjes 9.7.1967, lindur dhe banues në Gjirokastër, ka konsumuar veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

19.6 Në datën 26.5.2014, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

19.7 Në datën 27.5.2014, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, pasi studioi aktet e procedimit penal nr. ***, viti 2014, vendosi disa masa provizore në drejtim të pasurive dhe llogarive bankare të subjekteve tregtare, si dhe të personave fizikë, aksionerë të tyre. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit, ndër të tjera edhe nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. I.M.

Analiza ligjore e fakteve

19.8 Referuar ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 3, pika 15 e tij, parashikohet se: *“Person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënues apo proceduar penalisht brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur:*

- a) *Procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet;*
- b) *Deklarohet i pafajshëm nga gjykata, pasi vepra është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet”.*

19.9 Referuar procedimit penal nr. ***, viti 2014, duket se shtetasi I.M është proceduar nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjirokastër për një nga veprat penale të parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar. Pavarësisht se procedimi penal është pushuar, shtetasi I.M, bazuar në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, konsiderohet person i përfshirë në krimin e organizuar.

¹⁷ Referimi i veprës penale te prokurori: 1. Me marrjen e njoftimit për një vepër penale, policia gjyqësore, pa vonesë, i referon prokurorit me shkrim elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë. Ajo njofton, kur është e mundur, edhe gjeneralitetet, banesën dhe çdo gjë që vlen për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të personit të dëmtuar dhe të atyre që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit. 2. Kur ka urgjencë dhe në rastet e krimeve të rënda, njoftimi bëhet menjëherë edhe me gojë. 3. Me njoftimin, policia gjyqësore tregon ditën dhe orën në të cilën ka marrë dijeni për veprën penale.

Në lidhje me pozitën procedurale të babait të subjektit në raport me kallëzimin e bërë nga ana e Drejtorisë së Policisë Gjirokastrë dhe hetimin e bërë nga Prokuroria

19.10 Në interpretim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me terminologjinë e përdorur për subjektet e veprës penale, trupi gjykues konstatoi se pozita procedurale e z. I.M ka qenë “person ndaj të cilit zhvillohen hetimet”.

19.11 Nga hetimi rezultoi se në deklaratën *Vetting*, në seksionin “Angazhime nga veprimtari private”, subjekti ka deklaruar se ka qenë e punësuar pranë shoqërisë “****” sh.p.k., me funksion juriste nga data 21.4.2014 deri më 6.12.2015. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit për detyrat që ka pasur në funksionin e juristes së shoqërisë “****” sh.p.k., dhe subjekti sqaroi se detyrat funksionale kanë qenë asistenca e përgjithshme juridike, që lidhej kryesisht me menaxhimin e përgjithshëm të kontratave dhe praktikave tregtare.

19.12 Në lidhje me informacionet që disponohen në ngarkim të shtetasit I.M, bazuar në nenin 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës, ku duket se:

Shtetasi I.M hyn në rrethin e personave të përfshirë në krimin e organizuar dhe nga ana juaj si subjekt i rivlerësimit nuk është deklaruar ky fakt gjatë plotësimit të formularit për kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit DH, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

*Fakti që subjekti ishte e punësuar te shoqëria “****” sh.p.k. si juriste e shoqërisë, e cila hetohej për pastrimin e produkteve të veprës penale, jo vetëm konfirmon dijeninë e saj lidhur me procedimin e mësipërm dhe detyrimin e deklarimit të sa më sipër në formularin e kontrollit të figurës, por edhe duket se cenon dhe besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

19.13 Subjekti deklaroi se: “...në momentin e plotësimit të deklaratës nuk kam pasur dijeni për këtë fakt, pasi në të kundërt do e deklaroja sikurse kam deklaruar për dajën, i cili është dënues jashtë Republikës së Shqipërisë. Për këtë shkak, nuk mund të kisha asnjë iluzion që një fakt i tillë që i atribuohet babait tim dhe që ka ndodhur brenda vendit, nuk do të zbulohet... Sqaroj se puna si juriste ka qenë puna ime e parë dhe detyrat e mia funksionale lidheshin vetëm me menaxhimin juridik të kontratave dhe praktikave tregtare të shoqërisë. Edhe nga pikëpamja teknike një rast i tillë nuk mund t’i besohej për trajtim një juristeje të diplomuar në Bachelor dhe në atë kohë ndiqte studimet Master në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës...”.

19.14 Lidhur me dosjen penale dhe statusin e babait të saj në raport me ligjin dhe detyrimin për deklarim, ajo shpjegoi se: “...Sikurse vihet re në urdhrin “Për regjistrimin e procedimit penal”, datë 26.5.2014, në arsyetimin e tij konkludohet se për të grumbulluar të dhëna të nevojshme lidhur me përcaktimin e faktit dhe veprës penale, si dhe për individualizimin e përgjegjësisë penale dhe të personit që ka kryer veprën, është e domosdoshme kryerja e hetimeve të nevojshme të lidhura me ushtrimin e ndjekjes penale.

Në këto kushte, në bazë të nenit 287/1 dhe 315/3 të Kodit të Procedurës Penale, është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal, pa u përcaktuar emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale apo i personit nën hetim. Sikurse vihet re nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të procedimit

penal nr. ***/2014, nga ana e prokurorit nuk është nxjerrë asnjë akt, me të cilin t'i atribuohet babait tim vepra penale e regjistruar.

Siç vihet re lehtësisht në regjistrin e regjistrimit të veprave penale, të dhënat e shënuara janë:

- Në kolonën me titull “Nr. procedimi” është shënuar nr. procedimi ***;
- Në kolonën “Nr. shkrese” është shënuar numri ***;
- Në kolonën “Person i dëmtuar” është shënuar Dr.Po.Q. Gjirokastër dhe poshtë saj shënuar kallëzim për I.M;
- Në kolonën “data e regjistruar” është shënuar data 26.5.2018;
- Në kolonën “Prokuroria” është shënuar emri i prokurorit P.D dhe T.Ç (i cili duhet të jetë emri i Oficerit të Policisë Gjyqësore);
- Në kolonën “Lloji i veprës penale” është shënuar “Pastrimi i produkteve të veprës penale”;
- Në kolonën “Neni” është shënuar neni 287.

19.15 Subjekti shpjegon se: “Të gjitha kolonat e tjera, përfshirë atë me titull “Autori i veprës penale”, janë pa asnjë shënim, për të vijuar në fund me kolonën me titull “Kur ka përfunduar/datë” është vendosur shënimi “Pushuar më 30.12.2014”.

19.16 Sikurse provohet edhe nga shqyrtimi i fashikullit të procedimit penal nr. ***/2014, subjekti shpjegon se babai i saj nuk ka pasur në asnjë rast pozitën procedurale të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime apo të personit të marrë si i pandehur. Subjekti Klerona Meçi shpjegon se: “...Ai ka pasur vetëm statusin e personit ndaj të cilit është paraqitur një kallëzim nga drejtoria për krimin ekonomik dhe financiar. Edhe në dispozitivin e vendimit për pushimin e procedimit penal nr. ***/2014, konkretisht në pikën 1 të tij, citohet se “vendosi të pushojë hetimet e çështjes penale, për arsye se faktet e relatuara dhe të hetuara nuk përbëjnë veprë penale”. Pra, jemi në kushtet kur në urdhrin e regjistrimit të procedimit në fjalë, të përmendur më sipër, si dhe në aktet e tjera të mëvonshme, nuk është përmendur asnjëherë emri i babait tim si person ndaj të cilit zhvillohet një procedim penal. Prokurori i çështjes ka hetuar vetëm faktet e relatuara nga kallëzuesi pa ia atribuar këto fakte babait tim, duke konkluduar në përfundim se këto fakte nuk përbëjnë veprë penale. Gjithashtu, sqaroj se babai im nuk është thirrur të pyetet asnjëherë nga prokuroria, qoftë në cilësinë e personit që ka dijani për veprën, qoftë në ndonjë cilësi tjetër procedurale, sikurse parashikon neni 296 i Kodit të Procedurës Penale. Për më tepër, ky vendim i prokurorit të çështjes, siç rezulton nga materialet e fashikullit të procedimit, nuk është ankimuar nga subjekti i interesuar dhe ka marrë formë të prerë”.

19.17 Në lidhje me konstatimin e Komisionit se pozita procedurale e shtetasit I.M “në momentin kur organi procedural po hetonte, është shndërruar në “person ndaj të cilit zhvillohen hetime”, subjekti sqaron se statusi procedural i personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, është një moment i rëndësishëm procedural, i cili sipas ligjit të kohës shoqërohet me veprime konkrete, sikurse është akti procedural i prokurorit, i cili i njoftohet personit ndaj të cilit merret. Ky moment shënon fillimin e një sërë të drejtash dhe detyrimesh që përcaktohen nga Kodi i Procedurës Penale. Ky hetim ka zgjatur më shumë se 3 muaj (konkretisht 7 muaj) pikërisht për faktin se në momentin e regjistrimit të kallëzimit nuk është regjistruar asnjëherë

emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale. Në fashikullin e procedimit penal nr. ***/2014 nuk ka vendim të prokurorit për zgjatjen e afateve të hetimit, sikurse parashikon neni 324 i Kodit të Procedurës Penale.

19.18 Subjekti parashtron se: *“...edhe terminologjia e përdorur si nga prokurori, ashtu dhe nga gjykata, i referohet shtetasit I.M, duke qenë të kujdesshëm për të mos i dhënë atij në asnjë rast statusin procedural të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime apo atë të pandehurit. Sa më sipër, në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, person i proceduar penalisht nuk mund të konsiderohet personi të cilit kallëzuesi i atribuon një veprim të caktuar, që sipas vlerësimit të tij përbën vepër penale”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

19.19 Trupi gjykues, pasi administroi provat e rezultuara gjatë hetimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në lidhje me prapësimet e saj me shkrim dhe në seancën dëgjimore, konstaton se:

19.20 Referuar pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, shtetasi I.M nuk është i dënuar dhe as i proceduar penalisht për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, pasi ky person nuk ka marrë cilësinë e personit nën hetim dhe nuk është marrë si i pandehur. Sipas fletës së regjistrimit të veprave penale, rezultoi se emri i shtetasit I.M nuk është regjistruar si person nën hetim, megjithëse vepra e regjistruar i atribuohet atij si përfaqësues ligjor i shoqërive. Fakti i mosregjistrimit të shtetasit I.M në regjistrin e veprave penale në cilësinë e personit të proceduar penalisht nuk e bën atë ligjërisht një kontakt të papërshtatshëm për subjektin e rivlerësimit, duke përjashtuar kështu detyrimin e subjektit për ta deklaruar si kontakt të papërshtatshëm në deklaratën e kontrollit të figurës.

19.21 Trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse për padijeninë e saj, kjo për shkak të periudhës së shkurtër të ushtrimit të detyrës, mungesës së eksperiencës dhe faktit që nuk është e mjaftueshme ekzistenca e marrëdhënies së punësimit për të provuar dijeninë për këtë procedim penal.

19.22 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Klerona Meçi, ka plotësuar në mënyrë korrekte deklaratën për kontrollin e figurës, pavarësisht dijenisë ose jo të saj lidhur me procedimin penal nr. ***, viti 2014, për veprën “Pastrimi i produkteve të veprës penale”; formalisht emri i shtetasit I.M nuk figuron si person i regjistruar në regjistrin e veprave penale si autor i veprës penale dhe, për pasojë, ai nuk mund të konsiderohet si kontakt i papërshtatshëm në kuptim të pikës 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”.

19.23 Sa më sipër, në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016: *“Person i proceduar penalisht nuk mund të konsiderohet personi të cilit kallëzuesi i atribuon një veprim të caktuar, që sipas vlerësimit të tij përbën vepër penale”.*

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

20. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në: (a) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja; (b) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 165 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; (c) dokumentacionin e mbledhur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

20.1 Në mbështetje të pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme vlerësohet bazuar në:

- a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura;
- b) rezultatet e testimin në Shkollën e Magjistraturës.

Lidhur me kriterin e parë vlerësues, relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura

a) Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Nga verifikimi i dokumenteve ligjore të dorëzuara nga subjekti, Këshilli i Lartë i Prokurorisë në raportin që i ka përcjellë Komisionit ka konkluduar se: (i) Dokumenti ligjor “Relacion mbi shqyrtimin e rekomandimeve të raport-inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me kontrollin e ushtruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë, datë 5.6.2016”; (ii) Dokumenti ligjor “Relacion mbi verifikimin e shkëlqeve të kryera nga prokuroria M.F, të ngritura në informacionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, G.Sh, datë 24.3.2016”; (iii) Dokumenti ligjor “Relacion mbi raport-inspektim”; (iv) Dokumenti ligjor “Relacion vendim për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***/14 Prokuroria e Rrethit Korçë, datë 26.9.2016”; (v) Dokumenti ligjor “Relacion për shfuqizimin e vendimit të pushimit”, janë të strukturuar në katër pjesë: (i) Rrethanat e faktit; (ii) Vendimi i pushimit të procedimit penal dhe arsyeimi i tij; (iii) Shqyrtimi i akteve dhe vendimit të pushimit; (iv) Në lidhje me zgjidhjen ligjore dhe detyrat. Për sa i përket strukturës së analizës, rezulton se pjesët dhe paragrafët janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt, të radhitura me etikë e numërtime, duke respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive, të cilat janë lehtësisht të kuptueshme, ku pasqyrohet hollësisht dhe informacioni i grumbulluar. Akti paraqitet i strukturuar dhe i shkruar në një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore, në funksion të qartësisë së arsyesimit. Relacionet janë nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit Klerona Meçi.

b) Pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura me short

Gjetjet nga vëzhgimi i këtyre pesë dosjeve

Dosja 1 – Dokumenti ligjor – Akt kontroll nr. *, datë 28.7.2016.** Në mbështetje të nenit 27/c të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në urdhrin nr. 863, datë 20.1.2015 “Për kontrollin e procedimeve penale të mbartura në hetim për vitin 2016”, urdhrin nr. 5, datë 24.3.2016 “Për kontrollin e procedurës së regjistrimit të çështjeve dhe akteve të tjera në prokurori”, urdhrin nr. 4, datë 24.3.2016 “Për ushtrimin e kontrollit në fazën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe zbatimit të ligjit për amnistinë”, të drejtuesit të Prokurorisë, z. B.C, u ushtrua kontroll i brendshëm nga stafi drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Nga Prokuroria e Përgjithshme u dërgua një grup për të verifikuar kontrollin e brendshëm të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Grupi i punës konstatoi se nga kontrolli i veprimtarisë së 20 prokurorëve, 5 prej tyre kanë rezultuar me një numër të konsiderueshëm procedimesh të mbartura nga viti 2015 dhe tremujori i parë i vitit 2016, e

konkretisht prokurorët E.M, M.T, B.B, E.K dhe H.M. Kanë konstatuar se pas inspektimit në një kohë të shkurtër këta prokurorë kanë hequr shumicën e procedimeve dhe kallëzimeve, të cilat kanë rezultuar me zvarritje. Në datën 28.7.2016, në ambientet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nga ana e drejtores së drejtorisë së inspektimit dhe burimeve njerëzore, znj. A.M dhe prokurorit, z. A.K, iu tërhoq vëmendja prokurorëve E.M, M.T, B.B, E.K dhe H.M dhe, në një inspektim të dytë, nëse për prokurorët e mësipërm konstatohen të njëjtat problematika në hetimin e procedimeve penale, atëherë të merren masa për fillimin e procedimit disiplinor. Pas kontrollit, prokurori A.K ka përgatitur një memo drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm. Kjo memo është konceptuar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Klerona Meçi.

Dokumenti ligjor – Akt kontroll mbi verifikimin e materialit të inspektimit, është i strukturuar në tri pjesë: (i) Hyrje; (ii) Faktet e konstatuara nga inspektimi; (iii) Konkluzione dhe rekomandime. Për sa i përket strukturës së analizës, rezulton se pjesët dhe paragrafët janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt, të radhitur me etikë e numërtime, duke respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive, të cilat janë lehtësisht të kuptueshme, ku pasqyrohet hollësisht edhe informacioni i grumbulluar nga inspektimi. Akti paraqitet i strukturuar dhe i shkruar në një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore, në funksion të qartësisë së arsyetimit. Duhet pasur në konsideratë se raporti është i konceptuar dhe nënshkruar jo vetëm nga subjekti i rivlerësimit Klerona Meçi, por edhe nga prokurori A.K.

Dosja 2 – Dokumenti ligjor – Memo nr. ***, datë 11.3.2016, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm. Përmbajtja e dokumentit: Në Prokurorinë e Përgjithshme kanë ardhur disa ankesa, të cilat fillimisht i kanë kaluar për shqyrtim drejtorisë së kontrollit të hetimit dhe ndjekjes penale, e cila ia ka kaluar për kompetencë drejtorisë së inspektimit dhe burimeve njerëzore. Memoja është e strukturuar dhe e ndarë në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese dhe kërkimi/sugjerimi. Memoja është e ndërtuar sipas standardit të akteve të kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese-argumentuese dhe përfundon me sugjerimin/kërkimin për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Akti është shkruar në një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore, në funksion të qartësisë së arsyetimit. Teksti është i qartë dhe i kuptueshëm. Duhet theksuar se dokumenti memo është nënshkruar nga prokurori A.P, ndërsa konceptimi është bërë nga subjekti i rivlerësimit, znj. Klerona Meçi.

Dosja 3 – Praktika nr. *** – Relacion për vendimin për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. ***. Përmbajtja e dokumentit: Në datën 1.9.2015, shtetasi L.B është shoqëruar së bashku me automjetin e tij tip “Mercedes-Benz” në Komisarjatin e Policisë Pogradec dhe nga ana e oficerit të policisë gjyqësore është kryer testi i alkoolit dhe, sipas procesverbalit, rezulton se shtetasi L.B ka përdorur alkool në masën 0.84%. Prokurorja e çështjes në datën 1.10.2015 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, bazuar në nenin 290, pika 1, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Penale. Subjekti i rivlerësimit, znj. Klerona Meçi, bazuar në nenin 4, pikat 4 e 5 dhe 287 të Kodit të Procedurës Penale, ka sugjeruar shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal lidhur me materialin referues nr. ***, viti 2015, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pogradec. Dokumenti ligjor “Relacion për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit”, është i strukturuar në katër pjesë: (i) Rrethanat e faktit; (ii) Vendimi i mosfillimit

të procedimit penal dhe arsyetimi i tij; (iii) Shqyrtimi i akteve dhe vendimit të pushimit; (iv) Në lidhje me zgjidhjen ligjore dhe detyrat. Akti paraqitet i strukturuar dhe i shkruar në një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore, në funksion të qartësisë së arsyetimit. Relacioni është i nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit.

Dosja 4 – Praktika nr. *** – Relacion për vendim shfuqizimi të vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, Prokuroria e Rrethit Korçë. Përmbajtja e dokumentit: Në datën 6.4.2015, shtetasi M.M duke drejtuar automjetin tip furgon ka aksidentuar shtetasin e mitur J.L. Sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor, shtetasi nga ky aksident ka pësuar frakturë të hapur të këmbës. Këto dëmtime kategorizohen si dëmtime që shkaktojnë paaftësi në punë në masën mbi nëntë ditë, por me një rivlerësim pas tre muajsh. Gjithashtu, për këtë ngjarje është kryer dhe aktekspertimi autoteknik për të përcaktuar shkakun e aksidentit, i cili ka arritur në konkluzionin se të dy përdoruesit e rrugës kanë shkelur rregullat e qarkullimit rrugor, të cilat kanë ndikuar në ardhjen e aksidentit. Por sipas ekspertit, shkakun determinant që ka sjellë pasojën, është shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga këmbësori (fëmija J.L). Prokurori i çështjes, pas kryerjes së veprimeve hetimore dhe shqyrtimit të akteve të procedimit penal nr. ***, viti 2015, ka vendosur pushimin e procedimit penal për veprën penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i Kodit Penal, duke u bazuar në nenin 328/1, shkronja “b” (fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale) e Kodit të Procedurës Penale. Subjekti i rivlerësimit, znj. Klerona Meçi, bazuar në nenin 24, pikat 4 e 5 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe pikat 1.4 e 4.1 të urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 148, datë 9.5.2008 “Për caktimin e hierarkisë në Prokurori”, ka sugjeruar: Shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, viti 2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Dokumenti ligjor “Relacion për shfuqizimin e vendimit të pushimit”, është i strukturuar në katër pjesë: (i) Rrethanat e faktit; (ii) Vendimi i pushimit të procedimit penal dhe arsyetimi i tij; (iii) Shqyrtimi i akteve dhe vendimit të pushimit; (iv) Në lidhje me zgjidhjen ligjore dhe detyrat. Akti paraqitet i strukturuar dhe i shkruar në një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore, në funksion të qartësisë së arsyetimit. Relacioni është i nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit.

Dosja 5 – Praktika nr. *** – Relacion për vendim shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. ***, Prokuroria Korçë. Përmbajtja e dokumentit: Në datën 30.4.2015 është gjetur i varur në banesën e tij shtetasi G.K. Sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. ***, datë 30.4.2015, në trupin e viktimës është konstatuar brazda e strangulimit në qafë. Prokurori i çështjes pas shqyrtimit të akteve të referuara nga policia në datën 29.5.2015 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për veprën penale “Shkaktimi i vetëvrasjes”, parashikuar nga neni 99/a i Kodit Penal, duke u bazuar në nenin 290/1, shkronja “ç” (fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale) e Kodit të Procedurës Penale. Subjekti i rivlerësimit, znj. Klerona Meçi, bazuar në nenin 24, pikat 4 e 5 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe pikat 1.4 e 4.1 të urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 148, datë 9.5.2008 “Për caktimin e hierarkisë në Prokurori” ka sugjeruar: “Shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal datë 29.5.2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, lidhur me materialin kallëzues nr. ***, datë 6.5.2015, për veprën penale të shkaktimit të vetëvrasjes, parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal”. Dokumenti ligjor “Relacion për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit” është i strukturuar në katër pjesë: (i) Rrethanat e faktit; (ii) Vendimi i mosfillimit të procedimit penal

dhe arsyetimi i tij; (iii) Shqyrtimi i akteve dhe vendimit të pushimit; (iv) Në lidhje me zgjidhjen ligjore dhe detyrat. Për sa i përket strukturës së analizës, rezulton se pjesët dhe paragrafët janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt, të radhitura me etikë e numërtime, duke respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive, të cilat janë lehtësisht të kuptueshme, ku pasqyrohet hollësisht dhe informacioni i grumbulluar. Akti paraqitet i strukturuar dhe i shkruar në një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkrimore, në funksion të qartësisë së arsytimit. Relacioni është i nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE

21. Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të Shkallës së Parë, të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe të burimeve arkivore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për subjektin e rivlerësimit Klerona Meçi rezulton se:

21.1 Nga të dhënat që ndodhen në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nuk rezulton të jetë marrë ndonjë masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit Klerona Meçi.

21.2 Ndaj subjektit të rivlerësimit Klerona Meçi nuk ka materiale hetimore.

21.3 Drejtoria e koordinimit institucional, si dhe sektori protokoll – arkiva në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2021, bën me dije se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme rezulton se nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave, në mënyrë manuale, për periudhën viti 2006 – 2021 rezulton se nuk ka ankesa.

21.4 Pranë drejtorisë ekonomike dhe të burimeve njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë ka të dhëna për vlerësimin e punës së këtij subjekti, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar, si dhe urdhrin nr. 221, datë 19.11.2012 “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”:

21.5 Konkretisht është administruar:

- i. Vendim i Prokurorit të Përgjithshëm “Për vlerësimin e punës së ndihmësit ligjor”, viti 2016, në nivel “shumë mirë”.

ANALIZA E GJETJEVE

22. Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti, pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short, të dhënave nga burimet arkivore në drejtorinë ekonomike dhe të burimeve njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

22.1 Aftësitë profesionale

- a) *Njohuritë ligjore*

Subjekti i rivlerësimit, ndihmësi ligjor Klerona Meçi, tregon korrektësi në zbatim të ligjit. Në tri aktet procedurale ligjore të paraqitura prej saj dhe në pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, është konstatuar se subjekti ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Klerona Meçi shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej saj janë të kuptueshme. Nga pikëpamja gjuhësore, ka respektuar rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur prej saj dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Aktet e përpiluara nga subjekti i rivlerësimit janë të konceptuara përgjithësisht me tre pjesë. Përmbajtja e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje. Rezulton se në aktet e përpiluara nga subjekti i rivlerësimit i kushtohet rëndësi tregimit të rrethanave të faktit. Në përmbajtjen e tyre (akteve) formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura.

22.2 Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura me short, qëndrimi i saj është brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural. Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal dhe Kushtetutës, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, subjekti i rivlerësimit ka përballuar ngarkesën e caktuar gjatë kohës në detyrë.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Nga praktikat e shortuara nuk ka të dhëna që subjekti i rivlerësimit, znj. Klerona Meçi, të ketë marrë pjesë në gjykim si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë e Përgjithshme.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, na njohin me faktin, me qëndrimin e Prokurorisë së Përgjithshme.

22.3 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Klerona Meçi, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tre dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

22.4 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në format letër dhe në 3 dokumentet e dorëzuara prej subjektit, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e Prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit ndihmësi ligjor Klerona Meçi rezulton të ketë marrë pjesë në trajnime siç është përmendur më lart.

Lidhur me kriterin e dytë vlerësues, rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës

23. Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2018, ka vendosur në dispozicion të Komisionit rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të parashikuara në pikën 4 të nenit 179/b të Kushtetutës dhe sipas parashikimeve të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

24. Nga verifikimi i tabelave të rezultateve u konstatua se në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale “Testi elektronik”, subjekti është vlerësuar me 55 pikë, nga 100 pikë të mundshme, ndërsa në fazën e dytë “Testi profesional” është vlerësuar me 101 pikë, nga 200 pikë të mundshme, duke mos u përzgjedhur për të ndjekur formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, në bazë të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

25. Rezultoi nga hetimi se ndaj subjektit të rivlerësimit nuk është marrë ndonjë masë administrative dhe gjithashtu nuk ka të regjistruar pranë Komisionit asnjë denoncim nga publiku.

Vlerësimi i Komisionit

26. Trupi gjykues çmon se në bazë të dokumentacionit të analizuar më sipër, subjekti ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Klerona Meçi:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 51, shkronjës “a”, të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Klerona Meçi, ndihmëse ligjore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 8.4.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Alma FASKAJ
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore (Kundër)

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku/Mevi Dibra